

Bujar Ahmedi, PhD¹
Arbër Ademi, PhD²

UDC: 343.8(497.7)
343.24/.26:340.13(497.7)

PËRGJEGJËSIA NDËRKOMBËTARE E SHTETEVE
МЕЃУНАРОДНА ОДГОВОРНОСТ НА ДРЖАВИТЕ
INTERNATIONAL RESPONSIBILITY OF STATES

Abstract

The international law represents a set of legal norms that regulate relations between the states. As such it has known many developments, thus taking on a new dimension compared to what it once represented. These changes, this new dimension did not happen by chance, it is the will of the states to put themselves in the service of international peace and security, to open the way for cooperation with each other. In this regard, new institutes of international law have been established and its existing institutes have been developed and perfected. The subject of this paper is the international responsibility of the states which is a legal institution of international law, the elements of the states' responsibility, the forms of responsibility.

The state as a subject of the international law, as a legal-political institution, which performs various functions both within its borders and outside those borders, is obliged to respect the international legal order. If a state undertakes an illegal act, which is sanctioned by

¹ Doktor i shkencave juridike. Ligjërues në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës.

² Doktor i shkencave juridike. Ligjërues në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës.

international law, then for that state its international responsibility will come to the fore. We will address some cases from the international law practice by taking into account the key elements in which the states' international responsibility charged for the illegal actions is expressed.

Keywords: *State responsibility, forms of responsibility, cases.*

PËRGJEGJËSIA NDËRKOMBËTARE E SHTETEVE

Përgjegjësia e shteteve përbën një parim të rëndësishëm të së drejtës ndërkombëtare që buron nga natyra e sistemit juridik ndërkombëtar dhe teoritë mbi sovranitetin dhe barazinë sovraane të shteteve.

Shteti si institucion juridiko-politik i cili kryen shumë funksione si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij është i detyruar që gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve të respektojë rendin juridik ndërkombëtar. Sipas kësaj del, që një shtet i cili kryen një akt të paligjshëm kundër një shteti tjetër, duhet që t'i nënshtrohet përgjegjësisë ndërkombëtare. Pra, sikurse në të drejtën e brendshme siç parashihet përgjegjësi juridike për mospërbushjen e një detyrimi ligjor, ashtu edhe në të drejtën ndërkombëtare për mospërbushjen e një detyrimi të importuar nga normat e së drejtës ndërkombëtare parashihet përgjegjësi ndërkombëtare.

Nisur nga kjo që theksuam më lartë, profesori Ksenofon Kristafi do të shprehet: *“subjekti e së drejtës ndërkombëtare nuk mund të pretendojnë të kenë vetëm të drejta ose vetëm favore dhe privilegje. Ato kanë edhe detyrime, mosrespektimi apo shkelja e të cilave sjellë përgjegjësinë juridike. Ngarkimi me përgjegjësi është një cilësi e pandarë e tyre.”*³

Praktika ndërkombëtare në shumë raste në të cilat janë cenuar normat e së drejtës ndërkombëtare ka konfirmuar përgjegjësi ndaj shteteve, me ç'rast shteti i cili nëpërmjet aktit të paligjshëm i ka shkaktuar ndonjë dëm shtetit tjetër apo ndonjë organizate ndërkombëtare është detyruar që të njëjtin dëm ta kompensojë..

Duhet të theksohet se e drejta ndërkombëtare nuk bën dallim midis përgjegjësive të kontraktuara dhe përgjegjësive të cilat burojnë nga shkelja e detyrimeve, kështu që cilado shkelje e përgjegjësisë nga ana e shteteve, cilido qoftë detyrim me çfarëdo qoftë prejardhje shkakton përgjegjësi ndërkombëtare, dhe si rrjedhojë e saj edhe detyrimin për

³ Kristafi, K (2015). *E drejta e organizatave ndërkombëtare*. Onufri Tiranë, f. 343.

reparacione.⁴ Pra, është parim i së drejtës ndërkombëtare që shkelja e një detyrimi të caktuar të detyrojë subjektin e së drejtës ndërkombëtare të kompensojë dëmin në një formë të caktuar.

Vështruar historikisht, në të drejtën ndërkombëtare më të hershme parashihej përdorimi i forcës nga shteti i dëmtuar ndaj shtetit dëmtues, me qëllim që këtë të fundit ta detyrojë për të plotësuar detyrimet ndaj tij. Pra, çështja e përgjegjësisë ndërkombëtare të shteteve përveç që përbën një parim shumë të rëndësishëm të së drejtës ndërkombëtare, ajo njëherit përbën edhe një nga institutet më të hershme të kësaj lëmie. Se me të vërtetë është kështu këtë e tregon edhe interesi që kanë treguar shumë autorë të së drejtës ndërkombëtare në shkrimet e tyre për këtë çështje si Hugo Groci, Emerik de Vatel, Dionisio Anzeloti,, Heinrich Triepelit, Hans Kelzen etj.

Çështja e përgjegjësisë së shteteve është trajtuar edhe në Konferencën e Hagës në vitin 1907, duke u bërë objekt kodifikimi i njërit prej akteve kryesore të saj, Konventës IV të saj, për ligjet dhe zakonet e luftës tokësore. Në nenin 3 të kësaj konvente theksohet:

Pala ndërluftuese që do t'i shkelë dispozitat e kësaj konvente do të duhet patjetër, nëse do të jetë e nevojshme, të paguaj kompensim të dëmit. Ajo do të jetë përgjegjëse për të gjitha aktet që do të kryejnë personat që i takojnë forcës së saj të armatosur

Midis dy luftërave botërore, çështja e përgjegjësisë ndërkombëtare të shteteve me rekomandim të Lidhjes së Kombeve do të shfaqet për shqyrtim në Konferencën e Hagës në vitin 1930, mirëpo përpjekjet e shteteve për të miratuar një rregullore për çështjen e përgjegjësisë së shteteve do të përfundojnë pa sukses.

Pas Luftës së Dytë Botërore, në kuadër të OKB-së, përsëri do të kemi një aktivitet të dendur në drejtim të përgatitjes së një dokumenti që ka të bëjë me përgjegjësinë ndërkombëtare të shteteve. Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare disa herë i ka propozuar Asamblesë së Përgjithshme paketë projekt-nenesh për miratim që kanë të bëjnë me këtë çështje, mirëpo deri më sot ende nuk kemi një epilog përfundimtar për kodifikimin e kësaj materie, që do të thotë se përgjegjësia ndërkombëtare e shtetit vazhdon të jetë një nga institutet e pakodifikuara të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, projekt-nenet e Komisionit të së drejtës ndërkombëtare, kanë fituar mbështetje të gjithanshme dhe realisht mund të themi sot se përfaqësojnë një **kod të parimeve mbi**

⁴ M. Sho (2009). *E drejta ndërkombëtare*. (Përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën maqedone nga Blagica Petreska Leposka). Prosvetno Delo, Shkup, f. 667.

përgjegjësinë ndërkombëtare të shteteve. Këto projekt-nene Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare që Asambleja e Përgjithshme e miratoi në formë të rezolutës më 12 dhjetor 2001.⁵

Në shumë marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe hasim në dispozita të cilat përmbajnë rregulla ku parashihet përgjegjësia e shtetit për veprime që janë ndesh me të drejtën ndërkombëtare. Për shembull, Konventa mbi detin e hapur e vitit 1958, 1962 dhe Konventa mbi të drejtën e detit e vitit 1982. Neni 22 i Konventës mbi detin e haur thekson: *Përveç rasteve kur intervenimi bazohet në autorizimet të dhëna me kontrata, anija luftarake që në det të hapur takon një anije të huaj tregtare, nuk mund të ndalohet nëse nuk ka arsye serioze të dyshimit.* Në paragrafin 3 të kësaj dispozite më tej theksohet: *Nëse dyshohet se dyshimet nuk janë të bazuara, dhe nëse anija e ndaluar nuk ka kryer asnjë akt, që e arsyeton, duhet të kompensohet çdo humbje apo çdo dëm.* Një dispozitë të këtillë e gjejmë edhe në Konventën e vitit 1962 në nenin 20 në të cilën theksohet: *Nëse sekuestrimi i anijes apo aeroplanit për shkak të dyshimit të piraterisë është kryer pa arsye të mjaftueshme, shteti që e ka kryer sekuestrimin është përgjegjës ndaj shtetit të cilit i takon anija apo aeroplani, për të gjithë humbjen apo dëmin që është shkaktuar me sekuestrimin.* Edhe në Konventën mbi të drejtën e detit në nenin 106 të saj shprehimisht thuhet: *Kur një arrestim i një anijeje ose hidroplani për dyshime në pirateri është kryer pa fakte të qarta, shteti, i cili bën një arrestim do të jetë përgjegjës përpara shtetit, kombësinë e të cilës zotëron anija ose hidroplani për çdo humbje ose dëmtrim të shkaktuar nga arrestimi.*

Edhe pse në këtë punim çështje trajtimi është përgjegjësia ndërkombëtare e shteteve, vlen të theksohet se edhe subjektet tjera të së drejtës ndërkombëtare si organizatat ndërkombëtare, kryengritësin si palë ndërluftuese ashtu dhe individët për veprimet e tyre që bien ndesh me të drejtën ndërkombëtare i nënshtrohen përgjegjësisë.

1.1 Elementet e përgjegjësisë së shteteve

Përgjegjësia ndërkombëtare është çdo herë raport i shtetit me shtet, kur shteti që ka pësuar dëm kërkon satisfaksion (kënaqje).⁶ Që një shtet të thirret në përgjegjësi ndërkombëtare e domosdoshme është që

⁵ Për më shumë shih rezolutën me numër 56/83 të 12 dhjetorit 2001 të miratuar nga Asambleja e Përgjithëshme e OKB-së në linkun: <https://undocs.org/en/A/RES/56/83>

⁶ Gruda, Z. (2002). *E drejta ndërkombëtare publike*. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë, f. 119.

të përmbushen disa kushte, të quajtura si elemente të përgjegjësisë së shteteve, edhe atë:

a) të ekzistojë veprimi ose mosveprimi (lëshimi), me të cilin cenohet ndonjë detyrim i përcaktuar me normat e së drejtës ndërkombëtare (traktat ndërkombëtar, zakon ndërkombëtar) që është në fuqi në shtetin përgjegjës për aktin dhe shtetin e dëmtuar nga ai akt. Pra veprimi i paligjshëm mund të kryhet me veprim si për shembull fillimi i agresionit ndaj shtetit tjetër, shkelja e imuniteteve dhe privilegjeve diplomatike. Si shembull të vënies përpara përgjegjësisë për shkak të mosveprimit, mund të përmendet rasti i incidentit të Kanalit të Korfuzit kur disa anije britanike hasën në mina dhe patën dëme të konsiderueshme në njerëz dhe materiale.

b) veprimi i paligjshëm duhet t'i mvishet shtetit si subjekt i së drejtës ndërkombëtare. Veprimi i paligjshëm mund t'i mvishet shtetit vetëm nëse akti i tillë është mosplotësim i një detyrimi ndërkombëtar. Veprimi i paligjshëm nuk mund t'i mvishet shtetit nëse është kryer nga individë të cilët atë veprim e kanë ndërmarrë duke vepruar ashtu për të realizuar ndonjë interes personal. Në një rast konkret, kur një shtet nuk respekton detyrimet nga traktati, lehtë konstatohet se kemi të bëjmë me një akt të paligjshëm të vetë shtetit e që rezulton me përgjegjësi ndërkombëtare të vetë shtetit. Por në anën tjetër, nëse veprimi i paligjshëm është kryer nga individë ose organe të caktuara brenda shtetit, në këtë rast duhet të se në emër të kujt është vepruar në atë formë. Nëse është vepruar në emër të shtetit, atëherë kemi përgjegjësi ndërkombëtare. Nëse konstatohet se nuk kemi të bëjmë me veprim të paligjshëm të ndërmarrë në emër të shtetit, atëherë nuk kemi shkelje të së drejtës ndërkombëtare.

c) me aktin e paligjshëm duhet që të jetë shkaktuar dëmi. Lidhur me dëmin Komisioni i së drejtës ndërkombëtare në projekt-nenet e hartuar nga ai në vitin 2001 në mes tjerash thekson se: *“Shteti përgjegjës për një veprim ndërkombëtarisht të padrejtë është i detyruar të kompensojë dëmin e shkaktuar prej tij, për aq sa një dëm i tillë nuk korrigjohet me kthim”*.⁷

d) duhet të jenë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike që parashihen nga e drejta e brendshme për të fituar kënaqje. Sipas kësaj del se, nuk duhet të shkelë detyrimet e ndryshme ndërkombëtare duke u thirrur në ligjet e veta që janë në fuqi në atë shtet.

⁷ Neni 36 i projekt-neneve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare mbi përgjegjësinë e shteteve për aktet ndërkombëtarisht të paligjshme të vitit 2001.

1.2 Lindja dhe llojet e përgjegjesisë ndërkombëtare

Kur flitet për “përgjegjësinë ndërkombëtare”, nga disa autorë të së drejtës ndërkombëtare përdoret termi *fakt i paligjshëm*. Mirëpo, nga Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare përdoret termi *akt i paligjshëm*. Kjo gjë vërehet në nenin 1 të projekt konventës në të cilën theksohet: “*çdo akt ndërkombëtar i paligjshëm i një shteti shtron përgjegjësinë e tij ndërkombëtare*”⁸ Edhe në nenet vijuese të këtyre projekt-neneve përdoret termi *akt*.

Në doktrinën dhe praktikën e së drejtës ndërkombëtare një ndër çështjet më të debatueshme është ajo se kur lind përgjegjësia ndërkombëtare, cili moment konsiderohet si moment i fillimit të përgjegjesisë. Në përgjithësi të gjithë autorët theksojnë se përgjegjësia lind atëherë kur një shtet i shkakton dëm shtetit tjetër. Për shembull, në rastin e anijes *I' Alone* Komisioni i Arbitrazhit urdhëroj SHBA-në që t'i kërkonte falje Kanadasë dhe të paguante dëmin e shkaktuar për veprimin e saj me ç'rast kishte ardhur deri te përmbytja e anijes. Kur flitet për lindjen e përgjegjesisë së shtetit është me rëndësi të theksohet se akti i paligjshëm sjellë pasoja juridike vetëm atëherë kur cenohet ndonjë normë juridike ndërkombëtare që është në fuqi.⁹ Për shkeljen e detyrimeve të cilat nuk kanë hyrë në fuqi nuk ka pasoja juridike. Disa autorë të së drejtës ndërkombëtare me të drejtë shtrojnë pyetjen se cili duhet të jetë momenti i lindjes së përgjegjesisë, momenti kur kemi shkelje të detyrimit ndërkombëtar apo atëherë kur ka elemente fajësie për sjelljen e shtetit me çka ka ardhur deri te shkaktimi i dëmit. Në këtë drejtim, përgjigjja është provuar të jepet nëpërmjet dy teorive: teorisë subjektive dhe teorisë mbi përgjegjësinë objektive.

Teoria subjektive ose teoria e fajit është formuluar nga Hugo Groci sipas të cilit ekzistimi i fajit të shkaktuar nga ana e organit shtetëror që ka bërë lëshime dhe nuk ka ndërmarrë masat e duhura shkaktonte përgjegjësi ndërkombëtare të shtetit. Sipas këtij autori, *padrejtësi konsiderohet çfarëdo faji, qoftë për veprim ose për lëshim, i cili është në kundërshtim me atë ç' duhet të bëj njeriu ose ç' është në interes të përgjithshëm. Nëse është bërë dëmi me faj, sipas të drejtës natyrore del detyrimi i shpagimit të dëmit. Këtë detyrim e mbajnë ata që e kanë shkaktuar dëmin ose kanë kontribuar të shkaktohet dëmi në masë më të madhe ose më të vogël.*¹⁰

⁸ Më tepër shih në: http://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/draft%20articles/9_6_2001.pdf

⁹ Shih nenin 13 të projekt konventës së Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare në http://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/draft%20articles/9_6_2001.pdf

¹⁰ Gruda, Z. (2013). *E drejta ndërkombëtare publike*. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë, f.145.

Për më tepër, bartës i përgjegjësisë është ai që urdhëron aktin e palejuar, ai që jep pëlqimin për të, ai që e ndihmon, ai që jep strehim; përgjegjës janë ata që japin këshilla, ata që nuk e pengojnë e kanë qenë, sipas së drejtës, të ngarkuar ta pengojnë, ata që nuk japin ndihmë e janë, sipas të drejtës, të detyruar ta japin. Të gjithë ata mund të dënohen nëse tek ata ekziston shkalla e mjaftueshme e qëllimit të keq që ta meritojnë dënimin.¹¹

Teoria objektive ose e rrezikut mbështetet në raportin midis aktit të paligjshëm të shtetit dhe dëmit të shkaktuar. Sipas kësaj teorie, përgjegjësia ndërkombëtare e shtetit ekziston që nga momenti i shkeljes së detyrimit të ndërkombëtar, pra, shteti është përgjegjës pavarësisht asaj a është me faj ose jo.

Teoria objektive është formuluar nga Anciloti dhe gjen mbështetje edhe nga autorë tjerë të së drejtës ndërkombëtare si: Guggenheim, Rousseau, Vazques etj. Sipas këtyre autorëve, kjo teori konsiderohet më e drejtë së teoria subjektive, sepse shtetet kanë një siguri më të madhe që mos pësojnë dëme të ndryshme.

Kjo teori gjen mbështetje dhe nga autorë tjerë të së drejtës ndërkombëtare si Heilborn, Ago, Strisower si dhe nga Instituti i së Drejtës Ndërkombëtare dhe Projekt Konventa për Përgjegjësinë Ndërkombëtare të Shteteve e Universitetit të Harvardit.

E drejta zakonore ndërkombëtare i ka mbështetur të dy teoritë. Në ditët e sotme zbatim më të gjerë ka teoria objektive ose teoria e rrezikut dhe kjo argumentohet me atë se “*çdo interpretim tjetër mund të përbënte një shteg më tepër në sistemin e papërsosur të drejtësisë ndërkombëtare*”.¹²

Përgjegjësia ndërkombëtare e shteteve mund të jetë: përgjegjësi e drejtpërdrejtë dhe përgjegjësi e tërthortë. Përgjegjësi e drejtpërdrejtë ekziston atëherë kur vetë shteti drejtpërdrejt shkel detyrimet ndërkombëtare. Lidhur me këtë, profesor Gruda, shprehet: “*Përgjegjësia e drejtpërdrejt ekziston në ato raste kur e kanë shkelë të drejtën ndërkombëtare organet shtetërore, për të cilat shteti mban përgjegjësinë, ose përfaqësuesit shtetëror*.”¹³ Edhe Martin Dikson lidhur me këtë çështje shprehet: “*Është normë e përgjithshme që çdo veprim ose mosveprim i organit të një shteti “do të konsiderohet akt i vetë atij shteti sipas së drejtës*

¹¹ Gruda, Z. (2013). *E drejta ndërkombëtare publike*. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë, f.145.

¹² Dikson, M (2010). *E drejta ndërkombëtare publike*. (Përkthim). Ais. Tiranë, f. 328.

¹³ Gruda, Z. (2013). *E drejta ndërkombëtare publike*. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë, f.146.

*ndërkombëtare, pavarësisht nëse organi ushtron funksione legislative, ekzekutive, gjyqësore ose të tjera, pavarësisht pozitës që ai ka në organizimin e shtetit dhe pavarësisht faktit nëse ai është organ i pushtetit qendror apo njësi territoriale e shtetit” dhe këtu “përfshihet... çdo person ose njësi, e cila ka këtë status në përputhje me legjislacionin e atij shteti”.*¹⁴ Pra, shteti si subjekt i së drejtës ndërkombëtare për çdo veprim ose mosveprim nëpërmjet të cilit ka ardhur deri te shkelja e normës të së drejtës ndërkombëtare mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë.

Përgjegjësia e tërthortë shfaqet atëherë, kur një shtet merr përgjegjësinë për shkeljen e normës të së drejtës ndërkombëtare nga ndonjë shtet tjetër. Profesor Zejnullah Gruda lidhur thekson se “*përgjegjësi të këtillë kemi midis shteteve që janë në ndonjë lidhje juridike të caktuar (si në federatë, protektorat, në mandate, te kujdestaria etj.)*”.¹⁵

Sipas vendimit të arbitrazhit në rastin Montijo, në mes të SHBA-ve dhe Kolumbisë (1875), shteti federal nuk mund të refuzojë zbatimin e së drejtës ndërkombëtare duke u mbështetur në paafësinë e vet ose zbrazëtirat e së drejtës së brendshme. Në të mirë të kësaj shkon edhe vendimi i qeverisë federale të SHBA-ve në lidhje me vrasjen e disa italianëve në Nju Orleans (1891) dhe përjashtimin e fëmijëve japonezë nga shkolla në San Francisko (1906). Qeveria federale i ka detyruar autoritetet e Luizianës ta bëjnë dëmshpërblimin në masë sa është e mundshme kurse ato të Kalifornisë ta revokojnë vendimin e përmendur.¹⁶

1.3. Veprimtaria e Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare dhe përgjegjësia ndërkombëtare e shteteve

Sipas nenit 13 të Kartës së OKB-së, Asambleja e Përgjithshme e saj ka për detyrë që nxisë “*zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare dhe kodifikimin e saj*”. Duke u thirrur në këtë dispozitë, Asambleja e Përgjithshme ka formuar një Komision të veçantë që përbëhet nga 34 anëtarë që janë ekspertë të dalluar të së drejtës ndërkombëtare, që vijnë nga qytetërimi të ndryshme. Akti më i Lartë në bazë të të cilit funksionon KND-ja është Statuti i KND-së (1947). Që në fillim të këtij akti afirmohet shprehimisht, shprehimisht qëllimi kryesor për të cilin është

¹⁴ Dikson, M (2010). *E drejta ndërkombëtare publike*. (Përkthim). Aiis. Tiranë, f. 331.

¹⁵ Gruda, Z. (2013). *E drejta ndërkombëtare publike*. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë, f.139.

¹⁶ Gruda, Z. (2013). *E drejta ndërkombëtare publike*. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë, f.129.

formuar ky komision ku theksohet: Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare do të ketë për qëllim promovimin e zhvillimit progresiv të së drejtës ndërkombëtare dhe kodifikimin e saj.¹⁷ Kështu, KND-ja duke u thirrur në dispozitat e Statutit, i ka hyrë punës për përgatitjen e një projekti të plotë për përgjegjësinë ndërkombëtare të shteteve me qëllim që edhe kjo fushë e së drejtës ndërkombëtare të jetë e kodifikuar. Pas një pune të gjatë dhe shumë përpjekjeve KDN-ja në gusht të vitit 2001 miratoi projekt-nene dhe i propozoi Asamblesë së Përgjithshme për miratim një paketë projekt-nenesh që kanë të bëjnë pikërisht me institutin e përgjegjësitë ndërkombëtare të shteteve. Asambleja e Përgjithshme këto projekt-nene të KND-së, pra çështjen përgjegjësisë ndërkombëtare të shteteve vendosi t'i përfshinte në rendin e ditës gjatë sesionit të pesëdhjetë e gjashtë të saj dhe i miratoi në formë të rezolutës.

Paketa e projekt-neneve për përgjegjësinë të shteteve për aktet e paligjshme ndërkombëtare përbëhet nga 59 nene dhe është e ndarë në katër pjesë.

Pjesa e parë e projekt-neneve trajton parimet e përgjithshme, elementet e përgjegjësisë ndërkombëtare, natyrën e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, situatat kur shtetet janë të ngarkuar me përgjegjësi përmes akteve nga organet e tyre legjislative, administrative dhe gjyqësore, aktet e kryengritësve, individëve.

Pjesa e dytë e projekt-neneve merret me përmbajtjen e përgjegjësisë ndërkombëtare të shtetit, pasojat e përgjegjësisë, si dhe shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare.

Pjesa e tretë e projekt-neneve me emrin zbatimi i përgjegjësisë ndërkombëtare të një shteti përfshin dispozitat nga 42-54 të cilat tregojnë për mënyrën nëpërmjet të cilave një shtet i dëmtuar mund të kërkojë ngarkimin me përgjegjësi për shtetin fajtor. Në këtë pjesë kemi dhe dispozita që kanë të bëjnë me njoftimin mbi pretendimin për përgjegjësi nga shteti i dëmtuar, pranueshmërinë e kërkesës, humbjen e së drejtës për të thirrur në përgjegjësi, kur disa shtete janë të dëmtuara nga një akt i kundërligjshëm, kur disa shtete janë përgjegjëse për një veprim të kundërligjshëm, si dhe kundërmasat.

Pjesa e katërt ka të bëjë me dispozita të përgjithshme. Në fund të kësaj pjese përmbyllëse kemi dispozitën në të cilës sqarohet se rastet në të cilat si përgjegjës na paraqitet një organizatë ndërkombëtare dhe rastet kur përgjegjësinë e ndajnë një shtet me një organizatë ndërkombëtare.

¹⁷ Neni 1 i Statutit të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare.

Këto projekt-nene, vërtetë sot përbëjnë një kod të parimeve të së drejtës ndërkombëtare për përgjegjësinë ndërkombëtare të shteteve, apo siç shprehet Martin Dikson “*kanë një rol të madh për të nxitur zhvillimin e një kodi gjithëpërfshirës juridik për përgjegjësinë e shtetit*”.¹⁸ Në paketën e projekt-neneve afirmohen kryesisht këto parime: çdo akt i paligjshëm ndërkombëtar i shtetit shtron përgjegjësi juridike për atë shtet, shteti nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia ndërkombëtare duke u bazuar në ligjet e tij, shteti mban përgjegjësi për veprimet e organeve të veta kur këto janë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, aktet e kryengritësve shkaktojnë përgjegjësi ndërkombëtare nëse kryengritësit bëhen qeveri e re e atij shteti dhe shtetin e ri që është krijuar në territorin që më parë është kontrolluar nga kryengritësit, përgjegjësia ndërkombëtare ekziston kur atë e ka shkaktuar shteti si subjekt i së drejtës ndërkombëtare, shteti i cili i ndihmon shtetit tjetër të kryej një veprim të paligjshëm ndërkombëtar gjithashtu është përgjegjës, shteti është i detyruar të japë dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar nga akti i paligjshëm ndërkombëtar etj.

1.4. Veprimtaritë e organeve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe përgjegjësia ndërkombëtare

Nga qëndrimet e autorëve të së drejtës ndërkombëtare, po edhe në projekt-nenet e KDN-së, shteti mban përgjegjësi për veprimtaritë e të gjitha organeve të tij, legjislative, ekzekutive, gjyqësore nëse aktet janë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare ose kur i është bërë dëm shtetit tjetër ose ndonjë shtetasi të huaj.

Autori i së drejtës ndërkombëtare lidhur me përgjegjësinë dhe veprimtarinë e organeve të pushtetit shtetëror shprehet: “do të konsiderohet akt i vetë atij shteti sipas së drejtës ndërkombëtare, pavarësisht nëse organi ushtron funksione legjislative, ekzekutive, ose gjyqësore ose të tjera, pavarësisht pozitës që ai ka në organizimin e shtetit dhe pavarësisht nëse ai është organ i pushtetit qendror apo njësi territoriale e shtetit”.¹⁹

Përgjegjësia e shtetit për veprimtaritë e organit të tij legjislativ ekziston nëse shteti nxjerr ndonjë ligj që bie ndesh me të drejtën ndërkombëtare, lëshon të nxjerr ndonjë ligj që është i domosdoshëm për të

¹⁸ Dikson, M (2010). *E drejta ndërkombëtare publike*. (Përkthim). A.i.s. Tiranë, f. 325.

¹⁹ Neni 4, paragrafi 1 i projekt-neneve të KND-së mbi përgjegjësinë ndërkombëtare të shteteve.

plotësuar një detyrim ndërkombëtar ose nuk derogon ndonjë ligj është në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare.

Përgjegjësia e shtetit për veprimtaritë e organeve ekzekutive ekziston atëherë kur këto organe veprojnë në kundërshtim me normat e së drejtës ndërkombëtare. Nëse vjen deri te shkelja e normës të së drejtës ndërkombëtare si rezultat i punës së organeve ekzekutive, atëherë shteti është bartës i përgjegjësisë së këtillë dhe duhet që shtetit tjetër t'i shprehë keqardhje, të paguajë dëmin dhe dënojë fajtorët.

Përgjegjësia e shtetit për veprimtaritë e organeve gjyqësore ekziston atëherë kur gjykatat e një shteti e kanë cenuar normën e së drejtës ndërkombëtare në zbatimin ose interpretimin e së drejtës së brendshme. Deri te një cenim i këtillë mund të vijë si rezultat i ndërhyrjes së pushtetit ekzekutiv në punën e gjykatave e cila manifestohet me keqadministrim të drejtësisë, me një vendim jomeritor të gjykatës apo gjykim haptazi të padrejtë.

Kur një shtet ka pretendime kundrejt një shteti tjetër duke e akuzuar për “mohim të drejtësisë”, ai mund të shtrojë çështjen edhe përpara një gjykate ndërkombëtare. Por asnjë gjykatë ndërkombëtare nuk mund ta marrë çështjen në shqyrtim përpara se të jenë ezauruar të gjithë mjetet ligjore që vë në dispozicion legjislacioni i brendshëm i shtetit përgjegjës.²⁰

Jurisprudenca ndërkombëtare ka konstatuar në shumë raste përgjegjësinë ndërkombëtare të shtetit si rezultat i veprimtarisë së organeve të pushtetit shtetëror si p.sh., Vendimi i Gjykatës së Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare lidhur me këmbimin e popullsisë midis Greqisë dhe Turqisë 1925, Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me çështjen e Ambasadës së SHBA-së në Teheran 1980, Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit lidhur me mosmarrëveshjen ndërmjet Britanisë së Madhe (Kanadasë në kohën kur ishte dominion britanik) dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës për çështjen e anijes *I'm Alone* në vitin 1935, Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi Incidentin e Kanalit të Korfuzit 1949 etj.

1.5. Pasojat e përgjegjësisë ndërkombëtare

Kur një shtet vihet para përgjegjësisë ndërkombëtare për një akt të paligjshëm me ç'rast i është shkaktuar ndonjë dëm një shteti tjetër, i duhet të përballlet me pasojat që sjellë përgjegjësia.

²⁰ Puto, A (2008). *E drejta ndërkombëtare publike*. Tiranë, f. 196.

Për të zgjidhur këtë çështje e drejta ndërkombëtare u referohet rregullave të së drejtës civile, sipas të cilave përgjegjësia përfshin detyrimin e subjektit përgjegjës që të rikthej sendin apo pasurinë e marrë padrejtësisht. Në të drejtën civile përgjegjësia ka si pasojë që subjekti të rikthejë këtë apo atë send në natyrë (restitucioni), të rimëkëmbë këtë apo atë pasuri në gjendjen e mëparshme (reparacion).²¹Nëse nuk është e mundur të realizohen veprimet e mësipërme, atëherë duhet të japë dëmshpërblimin.

Pra, edhe në të drejtën ndërkombëtare, shteti që ka shkaktuar aktin e paligjshëm është i detyruar që të kënaqë shtetin e dëmtuar, me anë të restitucionit, reparacionit dhe dëmshpërblimit.

Dëmshpërblimi është një shumë në të holla që kryhet për dëmin e shkaktuar ndaj një shteti nga ana e shtetit përgjegjës.

Dëmshpërblimi mund të bëhet në dy forma: me rikthimin në gjendjen e mëparshme, me kthim të sendit të ngjashëm ose me shpërblim në të holla. Rikthimi në gjendjen e mëparshme nënkupton kthimin në tërsin të status quos, dhe nëse kjo nuk është e realizueshme atëherë vjen në shprehje mënyra tjetër, pra kthimi i sendit të ngjashëm ose kompensimi me të holla. Kështu, p.sh., Izraeli i ka dhënë Kombeve të Bashkuara shumën që kap 54678 dollarë në emër të kompensimit të dëmit që kanë pësuar Kombet e Bashkuara me rastin e vrasjes së kontit Bernardote dhe njëherazi ka shprehur keqardhje që vepra ka ndodhur në territorin e tij dhe që fajtorët, përkundër përpjekjeve, nuk kanë mundur të zbulohen e të kapen.²²

Sipas, Gjykatës Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare , në vendimin e saj në rastin Fabrikës Chorzow (Germani-Poloni) 1928, konsideronte se dëmshpërblimi duhet që sa të jetë e mundur, t'i fshijë pasojat e aktit të paligjshëm dhe të rikthejë gjendjen që ka ekzistuar përpara se të të ndodhtë akti i paligjshëm.

Vendimi për dëmshpërblim disa herë përfshin dhe detyrimin që të kompensohet edhe fitimi i humbur që do kishte shteti sikur mos kishte ndodhur akti i paligjshëm që e ka dëmtuar.

Restitution in integrum si një mjet juridik në të drejtën ndërkombëtare, siç vërejtëm më lart derivon nga e drejta civile. Këtë institut e parashohin edhe projekt-nenet e Komisionit të së Drejtës ndërkombëtare mbi përgjegjësinë e shteteve në nenin 35 në të cilin thuhet:

²¹ Po aty, f. 200-201.

²² Gruda, Z. (2013). *E drejta ndërkombëtare publike*. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë, f.148

Një shtet përgjegjës për një veprim të paligjshëm ndërkombëtar është i detyruar të bëjë kthimin, d.m.th, të rivendosë situatën që ekzistonte përpara kryerjes së aktit të paligjshëm, me kusht dhe në masën që kthimi: a) nuk është materialisht i mundur; b) nuk përfshin një barrë jashtë çdo proporcioni me përfitimin që rrjedh nga kthimi në vend të kompensimit.

Në rast se rikthimi në gjendjen e mëparshme nuk mund të realizohet, atëherë vijnë në shprehje forma tjera, si kthimi i sendit të ngjashëm ose kompensimi në të holla. Kështu, p.sh., Anglia gjatë Luftës së Dytë Botërore, i ka ofruar Italisë që t'i japë një anije në vend të anijes së fundosur italiane "Llukania", e cila në bazë të marrëveshjes midis dy shteteve, i ka transportuar kolonët dhe punëtorët italianë nga Etiopia.²³

Po nëse dëmi është moral, atëherë përgjegjësia e shtetit është jomateriale. Në këto raste, jepet satisfaksioni si kompensim për cenimin e dinjitetit të shtetit të dëmtuar, pra kërkohet ndjesë ose falje.

Conclusion:

Norms on the international responsibility of states are norms which indicate the circumstances in which a subject of international law - the state, is subject to liability.

Thus, the international responsibility of states constitutes an important institution of international law. In order for the responsibility of the state to exist, the following conditions must be fulfilled:

a) there is an action or omission which violates an obligation stipulated by the norms of international law (international treaty, international custom) that is in force in the state responsible for the action and the state damaged by that act. The illegal action must be attributed to the state as a subject of international law.

b) the detriment must have been caused by the illegal action.

c) all legal remedies provided by the domestic law must be exercised.

It is a general rule that the breach of an international obligation which gives rise to liability, has certain legal consequences on the state which has caused this type of liability.

Until today, the norms of international law which regulate this field of international law are mainly of a customary nature despite the intense activity undertaken by the International Law Commission to codify this matter in this field.

²³ Po aty, f. 149.

However, the International Law Commission has prepared a package of draft articles that have been submitted to the General Assembly of the United Nations for approval, which have won the support of most of the states, and we can really say today that they represent a code of principles on international responsibility.

These are the draft articles of the International Law Commission that the General Assembly has adopted in the form of a resolution on 12 of December 2001.

Bibliografia

Literatura vendase

1. Gruda, Z. (2013). *E drejta ndërkombëtare publike*. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë.
2. Puto, A (2008). *E drejta ndërkombëtare publike*. Tiranë.
3. Kristafi, K (2009). *Diplomaci pas lufte. Negociatat me Italinë dhe Gjermaninë për dëmet e luftës në Shqipëri*. Tiranë.
4. Kristafi, K (2009). *Në kërkim të arit. Historia e arit shqiptar të rrëmbyer gjatë Luftës Dytë Botërore*. Botimet "Diata 2000". Tiranë.
5. Puto, A (2010). *Demokracia e rrethuar. Qeveria e Fan Nolit në marrëdhëniet e jashtme*. Shtëpia botuese Fan Noli. Tiranë.
6. Milo, P (2010). *Të vërtetat e fshehura - Incidenti i Kanalit të Korfuzit*. Toena. Tiranë.
7. Frqkoski, L/Tupurkovski, V/Ortakovski, V (1995). *Medjuna-rodno javno pravo*. Skopje.
8. Zaganjori, Xh. (2012). *Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare*. Tiranë.

Literaturë e huaj

9. Nollkaemper, A/Plakokefalos, I (2014). *Principles of shared responsibility in international law*. Cambridge University Press. Cambridge.
10. Kelsen, H (2017). *Teoria e përgjithshme e së drejtës dhe e shtetit*. Prishtinë.
11. Sho, N.M (2008). *Меѓународно право*. Просветно Дело ад. Скопје.
12. Ryzie, David (2006). *E drejta ndërkombëtare publike*. (përkthim në shqip). Shkup.

13. Koller, Xh/Lou, B (1999). *The Settlement of Disputes in International Law*. Oxford University Press. Oxford.
14. Dunne, T/Kurti, M/Smith, S (2007). *International relations theories Discipline and diversity*. Oxford University Press. Oxford.
15. Avnamov, Smileno, K (2007). *Medjunarodno javno pravo*. Beograd
16. Andrassy, J (1976). *Medjunarodno pravo*. Skolska kniga. Zagreb.
17. Dikson, M (2010). *E drejta ndërkombëtare publike*. (Përkthim). Ais. Tiranë.
18. Robert, K/Dikson, M (2010). *Случаи и материјали на меѓународното право (Përkthim)*. Shkup.
19. Bercovitch, J/Jackson, R (2009). *Conflict Resolution in the Twenty-first Century: Principles, Methods, and Approaches*. University of Michigan. Michigan.
20. Bercovitch, J/Sigmund, G (2009). *International Conflict Mediation*. Routledge. Neë York.
21. A Dictionary of Law. (2009). University press. Oksford.
22. Armstrong, D/ Liloyd, L/ Redmond, J. (2009). *Organizatat ndërkombëtare në Politikën Botërore. (Përkthim)*. Albanien Institute for International Studies. Tiranë. ADELPRINT. Tiranë.
23. Degen, V (2000). *Međunarodno pravo*. Pravni fakultet Sveučiliša u Rijeci. Rijeka.
24. Aust, A (2000). *Modern treaty law and practice*. University Press. Cambridge.
25. Handbook on the Peaceful Settlement of Disputes between States. United Nations. New York. 1992.
26. I, Vladimir (1972). *Rječnik međunarodnog javnog prava*. Informator, izdavačka kuca. Zagreb.
27. S.M.G, Koopmans (2008). *Diplomatic Dispute Settlement: The Use of Inter State Conciliation*. Cambridge University Press. Cambridge.
28. J.G, Merrills (2005). *International Dispute Settlement*. Cambridge University Press. Cambridge.
29. Stuart, S. Negal (2001). *Resolving International Disputes Through Super-Optimum Solutions*. Nova Science Publishers. New York.

Dokumente

30. Konventa e Hagës mbi ligjet dhe zakonet e luftës (1907).
31. Konventa mbi detin e hapur e vitit 1958.
32. Konventa mbi detin e hapur e vitit 1962.
33. Konventa mbi të drejtën e detit e vitit 1982.
34. Raporti i Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare mbi përgjegjësinë ndërkombëtare të shteteve paraqitur në formë rezolute nga Asambleja e Përgjithshme 56/83 më datë 12.12.2001.
35. Statuti i Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare
36. Karta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
37. Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.
38. Rregullorja e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.